

Fjalat e Paqes



*Përnjëmend,
përnjëmend po ju them:
kush e dëgjon falën time
dhe beson në atë
që më dergoi,
ka jetën e pasosur*
Gjn. 5, 24

Lajmëtar fetaro-kulturor i Arqipeshkvisë Metropolitane Shkodër - Pult Nr. 2 (115) Viti XVI Shkurt 2014 - Mars 2014

PAPA FRANÇESKU NA THËRRET PËR KTHIM TEK ZOTI

Papa Françesku ka dërguar të gjithëve mesazhin e Tij për Kreshmet me temë: "Është bërë i varfër për të na pasuruar me varfërinë e tij (2 Kor 8,9)". Me gëzim e paraqesim në vazhdim:

"Të dashur vëllezër e motra, me rastin e Kreshmës, ju ofroj disa reflektime, që të mund t'ju shërbejnë për ecjen personale dhe bashkësiore të kthimit. Marr nxitjen nga shprehja e shën Palit: "Ju e njihni bujarinë e Zotit tonë Jezu Krishtit, i cili, duke qenë i pasur, u bë për ju i varfër, që ju të bëheni të pasur me anë të varfërisë së tij" (2 Kor 8,9). Apostulli u drejtohet të krishterëve në Korint për t'i inkurajuar të jenë bujar duke ndihmuar besimtarët e Jerusalemit që gjenden në nevojë. Çfarë na thonë ne, të krishterëve të sotëm, këto fjalë të shën Palit? Çfarë na thotë sot neve ftesa për varfëri, për një jetë të varfër në kuptimin ungjillor?"

Hiri i Krishtit

Përpara së gjithash na thonë se cili është stili i Zotit. Zoti nuk zbulohet me mjetet e fuqisë dhe të pasurisë së botës, por me ato të dobësisë dhe varfërisë: "nga i pasur që ishte, është bërë i varfër për ne..." Krishti, Biri i Atit të amshuar, i njëjtë në fuqi e lavdi me Atin është bërë i varfër; ka zbritur mes nesh, është bërë i afërm i secilit prej nesh; është zhuverë, "boshatisur", për t'u bërë në gjithçka i ngjashëm me ne" (krh.

Fil 2,7; Heb 4,15). Është një mister i madh mishërimi! Por arsyeja e gjithë kësaj është dashuria hyjnore, një dashuri që është hir, bujari, dëshirë për afërsi, dhe nuk heziton të dhurohet e të sakrifkohet për krijesat e dashura. Bamirësia, dashuria është të ndash në gjithçka fatin e të dashurit. Dashuria bën të ngjashëm, krijon ngjashmëri, prish mure dhe distanca. Dhe Hyji ka bërë këtë me ne. Jezusi, në fakt, "ka punuar me duar njeriu, ka menduar me inteligjencë njeriu, ka dashur me zemër njeriu. Duke lindur nga Maria Virgjër, ai është bërë me të vërtetë njëri prej nesh, në gjithçka i ngjashëm me ne përveçse në mëkat" (Konc. Ekum. Vat. II Gaudium et Spes).

Qëllimi i bërjes i varfër i Jezusit nuk është varfëria në vetvete, por – thotë Shën Pali – "... që ju të bëheni të pasur përmes varfërisë së tij". Nuk bëhet fjalë për një lojë fjalësh, për një shprehje. Përkundrazi është një përmbledhje e logjikës së Hyjit, logjika e dashurisë, logjika e

Mishërimit dhe e Kryqit. Hyji nuk ka bërë që të bjerë mbi ne shpëtimi prej së larti, si një lëmoshë e atij që jep prej tepricës së tij me një besim të shtirë bamirësie (pietizëm flantropik). Nuk është kjo dashuria e Krishtit! Kur Jezusi zbret në ujërat e Jordanit dhe pagëzohet nga Gjon Pagëzuesi, nuk e bën se ka nevojë për pendesë, për kthim; e bën që të vendoset mes njerëzve, nevojtarë për falje, në mes nesh mëkatarëve, dhe ngarkohet me peshën e mëkateve tona. Është kjo rruga që ka zgjedhur për të na ngushëlluar, shpëtuar, liruuar nga mjerimi ynë. Na trondit që Apostulli thotë që jemi liruuar jo përmes pasurisë së Krishtit, por përmes varfërisë së tij. Dhe madje shën Pali I njeh mirë "pasuritë e pashqyrtueshme të Krishtit" (Ef 3, 8), "trashëgimtar i të gjitha gjërave" (Heb 1,2).

Çfarë është atëherë kjo varfëri me të cilën Jezusi na liron dhe na bën

të pasur? Është pikërisht mënyra e tij për të dashur, aftësia e tij për t'u bërë i afërm me ne si Samaritani i mirë që i afrohet njeriut të lënë gjysmë i vdekur mes rrugës (Lk 10, 25). Ajo çka na jep liri të vërtetë, shpëtim të vërtetë dhe lumturi të vërtetë është dashuria e tij me mëshirë, me butësi dhe bashkëndarje, varfëria e Krishtit që na pasuron është fakti se bëhet mish, se merr mbi vete dobësitë tona, mëkatet tona, duke na dhuruar mëshirën e pafund të Hyjit. Varfëria e Krishtit është pasuria e tij më e madhe:

Jezusi është i pasur me besimin e tij të pakufishëm në Hyjin Atë, me besimin e Atij në çdo moment, duke kërkuar gjithmonë vetëm vullnetin e tij dhe lavdinë e tij. Është i pasur ashtu si është një fëmijë që ndihet i dashur dhe do prindërit e tij dhe nuk dyshon asnjë çast për dashurinë dhe butësinë e tyre. Pasuria e Jezusit është të qenurit e tij Bir, marrëdhënia unike me Atin është privilegji i këtij Mesie të varfër.

Kur Jezusi na fton të marrim mbi ne "zgjedhën e tij të ëmbël", na fton të pasurohemi me këtë " varfëri të pasur" dhe "pasuri të varfër", të bashkëndajmë me Të Shpirtin bijësor dhe vëllazëror, të bëhemi bij në Birin, vëllezër në Vëllain e parëlindur (Rom 8,29). Është thënë që trishtimi i vërtetë është të mos jemi shenjtër (Leon Bloy); mund edhe të themi që është vetëm një mjerim: të mos jetojmë si bij të Hyjit dhe vëllezër të Krishtit.

Vijon në fq. 2



PAPA FRANÇESKU NA THËRRET PËR KTHIM TEK ZOTI

Vijim i fq. 1

Dëshmia jonë

Mund të mendojmë që kjo “rrugë” e varfërisë ka qenë rruga e Jezusit, ndërsa ne, që vijmë pas Tij, mund të shpëtojmë botën me mjete të përshtatshme njerëzore. Nuk është kështu. Në çdo epokë dhe në çdo vend, Hyji vazhdon të shpëtojë njerëzit dhe botën përmes varfërisë së Krishtit, i cili bëhet i varfër në Sakramente, në Fjalën dhe në Kishën e tij, që është një popull të varfërish. Pasuria e Hyjit nuk mund të kalojë përmes pasurisë sonë, por gjithmonë dhe vetëm përmes varfërisë sonë, personale dhe bashkësiore, të gjallëruar prej Shpirtit të Krishtit.

Duke imituar Mësuesin tonë, ne të krishterët jemi të thirrur të shohim mjerimet e vëllezërve, t'i prekim, t'i marrim mbi vete dhe të veprojmë konkretisht për t'i lehtësuar. Mjerimi nuk është varfëria; mjerimi është varfëria pa besim, pa solidaritet, pa shpresë. Mund të dallojmë tre lloje

mjerimi: mjerimi material, mjerimi moral dhe mjerimi shpirtëror. Mjerimi material është ai që zakonisht quhet varfëri dhe prek ato që jetojnë në një situatë jo të denjë për personin njerëzor: të privuar nga të drejtat themelore dhe të mirat primare si ushqimi, uji, kushtet higjienike, puna, mundësia e zhvillimit dhe e rritjes kulturore. Përballë këtij mjerimi Kisha ofron shërbimin e saj, diakoninë e saj, për t'iu shkuar në takim nevojave dhe për të shëruar këto plagë që shpërftyrojnë fytyrën e njerëzimit. Në të varfrit dhe në të fundit ne shohim fytyrën e Krishtit;

duke dashur dhe duke ndihmuar të varfërit duam dhe i shërbejmë Krishtit. Angazhimi ynë orientohet të ndihmojë që të pushojë ne botë dhuna ndaj dinjitetit njerëzor, diskriminimi dhe padrejtësitë, që, në shumë raste janë zanafilla e mjerimit. Kur pushteti, luksi dhe paret bëhen idhuj, i kundërvihen kësaj nevojë për një ndarje të barabartë të pasurive. Prandaj, është e nevojshme që ndërgjegjet të kthehen kah drejtësia, barazia, thjeshtësia dhe bashkëndarja.

Jo më pak shqetësuese është mjerimi moral, që konsiston në mundësinë për t'u bërë skllëvër të vesit dhe mëkatit. Sa familje janë në ankth sepse dikush prej anëtarëve – shpesh i riu – është i imponitur nga alkooli, nga droga, nga lojërat e fatit, nga pornografia! Sa persona kanë humbur kuptimin e jetës, janë pa farë perspektive për të ardhmen dhe kanë humbur shpresën! Dhe sa persona janë të detyruar të pësojnë këtë mjerim nga kushtet shoqërore të padrejta, nga mungesa e punës që i privon nga dinjiteti që dhuron të çuarit e bukës në shtëpi, për mungesën e barazisë për të drejtën e edukimit dhe shëndetit. Në këto raste mjerimi moral mund të quhet vetëvrasje embrionale. Kjo formë mjerimi, që

është edhe shkak i shkatërrimit ekonomik, lidhet gjithmonë me mjerimin shpirtëror, që na godet kur largohemi nga Hyji dhe refuzojmë dashurinë e tij. Nëse mendojmë se nuk kemi nevojë për Hyjin, që në Krishtin na shtrin dorën, sepse mendojmë se na mjafton vetja, shkojmë drejt rrugës së dështimit. Hyji është i vetmi që vërtet shpëton dhe liron.

Ungjilli është i vetmi kundërhelm kundër mjerimit shpirtëror: i krishteri është i thirrur të çojë në çdo ambient lajmin lirues që ekziston falja e të keqes së bërë, që Hyji është më i madh se mëkati ynë dhe na do falas, gjithmonë, dhe që jemi bërë për bashkësinë dhe jetën e amshuar. Hyji na fton të jemi lajmëtar të gëzueshëm të këtij mesazhi mëshire dhe shprese! Është e bukur të provosh gëzimin e përhapjes së këtij lajmi të mirë, të bashkëndash thesarin që na është besuar, për të ngushëlluar zemrat e plagosura dhe për t'i dhënë shpresë shumë vëllezërve e motrave të mbështjellë nga errësira. Bëhet fjalë për të ndjekur dhe imituar

Jezusin, që ka shkuar drejt të varfërve dhe mëkatarëve si bariu drejt deles së humbur, dhe ka shkuar plot dashuri. Të bashkuar me Të mund të hapim me guxim rrugë të reja ungjillëzimi dhe promovimi njerëzor.

Të dashur vëllezër e motra, kjo kohë Kreshmësh, e gjetë mbarë Kishën të gatshme dhe e nxittë për t'u dëshmuar atyre që jetojnë në mjerim material, moral e shpirtëror mesazhin ungjillor, që përmbledhet në shpalljen e dashurisë së Atit të mëshirshëm, i gatshëm për të përqaftuar në Krishtin çdo person. Mund ta bëjmë në atë masë sa jemi të ngjashëm me

Krishtin, që është bërë i varfër dhe na ka pasuruar me varfërinë e tij. Kreshmët janë një kohë e përshtatshme për zhveshjen; e na bën mirë të pyesim veten nga cilat gjëra mund të privohemi me qëllim që të ndihmojmë të tjerët me varfërinë tonë. Mos të harrojmë që varfëria e vërtet dhemb: nuk do të ishte e vlefshme një zhveshje pa këtë dimension pendestar. Kam dyshime për lëmoshën që nuk kushton dhe nuk dhemb. Shpirti Shenjt, falë të cilit “porsi skamnorë e pra, bëjmë të pasur shumë; si ata që nuk kanë kurrgjë e kemi gjithçka” (2 Kor 6,10), i mbështettë këto qëllime tona dhe na forcoftë në kujdesin dhe përgjegjësinë ndaj mjerimit njerëzor, për t'u bërë të mëshirshëm dhe veprues të mëshirës. Me këtë dëshirë, siguroj lutjen time që çdo besimtar dhe çdo bashkësi kishtarë të përshkojë me fryt ecjen kreshmore, dhe ju kërkoj të luteni për mua. Zoti ju bekoftë dhe Maria ju ruajt.”

Nga Vatikani, 26 dhjetor 2013

Festa e Shën Shtjefnit, diakon dhe martir i parë

FORMIMI I VAZHDUESHËM I MESHTARËVE

Ipeshkvinjtë e Dioqezave të Shqipërisë, të Malit të Zi dhe të Kosovës kanë vendosur një program trevjeçarë për formimin e vazhdueshëm për meshtarët të shuguruar nga viti 2000.

Komisioni Kombëtar i Klerit ka përgatitur programin e formimit trevjeçar dhe Ipeshkvinjtë e kanë miraturar në Konferencën e mbajtur më 11-12 nëntor 2013. Takimi i parë u bë në Fshatin e Paqes në Shkodër në datat 17-18 mars, me temë: “*Meshtari: njësi jete*”. Kumtesat u

mbajtën nga Dt.sha Claudia Ciotti dhe Dom Gottfried Ugolini, ekspertë në formim.

Takimi filloi më 17 mars në orën 15.30 dhe mbaroi me 18 mars pas drekës. Morën pjesë Meshtarë nga Kosova, nga Mali i Zi dhe nga Shqipëria. Falënderohen Don Roberto Ferranti dhe Loreta Tomaj, sekretarë të Komisionit për punën të bërë.

PARAQITJA NË UNIVERSITET - SHKODËR
AKTET E SIMPOZIUMIT - EKSPOZITËS

Arqipeshkvia Metropolitane Shkodër-Pult dhe Famullia Shën Shtjefni, në mbyllje të kremtimeve për 1700 vjetorin e Ediktit të Milanos, ditën e premte, me 28 shkurt 2014, në orën 18.00, kanë promovuar librin: “Simpoziumi dhe Ekspozita Hartografike” tek Biblioketa e Universitetit. Referuan: Imzot Angelo Massafra, prof. Ardian Marashi, Atë Mario Imperatori SI dhe Z. Gjovalin Çuni. Moderator ka qenë prof. Zef Paci. Në vijm fjalimi i Arqipeshkvit:

Me këtë botim u bashkohemi qyteteve të ndryshme europiane që kanë kremtuar Ediktin e Milanos (313 pas Kr.), me të cilin 1700 vjet më parë perandorët e Perandorisë Romake të Perëndimit dhe të Lindjes, Konstantin Augusti dhe Licin Augusti, u dhanë fund të gjitha përndjekjeve për arsye të lidhura me zgjedhjen e fesë dhe shpallën zyrtarisht neutralitetin e pushtetit perandorak romak në lidhje me çfarëdo besimi. Duke nisur prej këtij momenti, edhe të krishterët mundën ta dëshmonin lirisht fenë e tyre, pa frikën se do të përndiqeshin apo të diskriminoheshin.

Kremtimet e kësaj ngjarjeje të madhe u bënë në Nish (Naisusi i hershëm, sot në Serbi), atdheu i perandorit Konstantin, në Milano, ekspozita e kushtuar Ediktit në Pallatin Mbretëror (deri më 17 mars) është përkufizuar si ngjarja kulturore më e rëndësishme e vitit. Kjo ekspozitë pastaj është zhvendosur në Romë më 27 mars që të vazhdojë deri më 15 shtator 2013, në selinë e Koloseut.

Në Nish me 20-21 shtator 2013 morëm pjesë edhe ne nga Shqipëria, me një delegacion.

Me ediktin e Milanos paganizmi reshti së qeni besimi zyrtar i Perandorisë dhe të krishterëve, ashtu si dhe të gjithë njerëzve, iu dha e drejta të ndiqnin besimin e zgjedhur lirisht, cilido të ishte ai, mjafton që të ishte në gjendje të siguronte paqe e begati dhe në këtë mënyrë të ishte në dobi të të gjithëve.

Konferenca Ipeshkvore Shqiptare ka pasur gëzimin dhe nderin të organizojë edhe këtu në Shqipëri një Simpozium Ndërkombëtar për të kremtuar Ediktin e Milanos. Kjo ngjarje e jashtëzakonshme është zhvilluar më 27 prill 2013 në kryeqytetin Tirana, pranë Tirana International Hotel. Duke kujtuar, veç të tjerash, se perandori Konstantin kishte prejardhje ilirike, realizimi i këtij Simpoziumi ka qenë edhe arsye e një krenarie më të madhe për ne shqiptarët.

Falënderoj moderatorin Prof. Ardian Marashi dhe ralatorët: Prof. Elizabeth De Palma, Prof. Marco Rizzi, Dr. Edmond Malaj, Prof. Jahja Drançollin për relacionet e tyre historike, me frymëmarrje të madhe shkencore e përmbytësore, si dhe Shkëlqesinë e Tij Imzot Gjergj Frendo, për aktualizimin e bërë prej tij. Edhe Prof. Dr. Sali Berisha, Kryeministri i asaj kohe.

Dhe në të vërtetë, rëndësia e Ediktit njihet njëzëri. Gabrio Lombardi, një ekspert i njohur i të drejtës romake, ka vënë në dukje me mendjemprehtësi se “Edikti i Milanos ka një domethënie epokale sepse shënon *initium libertatis* (fillim i lirisë) të njeriut modern”. Ky pohim na lejon të vëmë në dukje se Edikti i Konstantinit dhe Licinit nuk shënon thjesht fundin e përndjekjeve kundër të krishterëve, por, sidomos, aktin e lindjes së lirisë fetare. E drejta për ta

dëshmuar lirisht fenë personale jo vetëm është thelbësore për çdo njeri, por – siç mëson Konkili II i Vatikanit – është e drejta themelore në të cilën mbështeten dhe shartohen të gjitha të drejtat e tjera. Prandaj e paraqes tani me gëzim botimin e Akteve të Simpoziumit të zhvilluar në Tiranë. Mund të gjeni edhe tekstin e Ediktit të Milanos në gjuhën latine dhe atë shqipe, tekstin në gjuhën origjinale të dy relacioneve të paraqitura nga profesorët me prejardhje jo shqiptare si dhe disa fotografi.

Libri paraqet edhe kronikën e Ekspozitës Hartografike e bërë në Prishtinë, në Shkodër dhe në Tiranë, me shume foto që e

pasurojnë.

Duke i përsëritur falënderimet e mia, si personale ashtu edhe në emër të Konferencës Ipeshkvore Shqiptare, të gjithë atyre që kanë ndihmuar aktivisht në realizimin e këtij Simpoziumi e të Ekspozitës Hatograhike, dmth: Renovabis per financimin dhe Drejtorit të Caritasit Kombetare, Dt. Albert Nikolla, dhe të gjithë atyre që kanë marrë pjesë në të, u uroj që reflektimi mbi ngjarjen e madhe të Ediktit të Konstantinit, duke thelluar aspektet e tij të ndryshme, të na ndihmojë të gjithëve për të qenë persona konstruktivë, respektues të të tjerëve, të hapur ndaj dialogut, vëllazërisë, bashkimit, me qëllim që të ndërtojmë një botë më të drejtë, më të kthjellët, më paqësore.

Imzot Angelo Massafra OFM
Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pultit
President i Konferencës Ipeshkvore Shqiptare

KATEKEZA PËR RININË UNIVERSITARE

Arqipeshkvia Metropolitane Shkodër-Pult ka organizuar tek Salla Kardinal Koliqi në orën 18,00, katër katekeza krezhmore për rininë universitare me temë: “Fara e mirë që bëhet grurë”, sipas programit që vijon:

1. Me 13 mars 2014, e enjte: *A ka farë të mirë në arën time?* - Kush jam unë? Ligjëruesi: Imzot Angelo Massafra.
2. Me 20 mars 2014, e enjte: *Ara ime dhe bota që më rrethon: marrëdhëniet, lidhjet – me kë jam unë?*

- Ligjëruesi: Imzot Angelo Massafra.
3. Me 27 mars 2014, e enjte: *A don që të shkulum egjërën?* - Roli i shkencës dhe i fesë në shoshitjen e të keqes e të mirës.
 - Ligjëruesi: Atë Mario Imperatori SI.
 4. Me 3 prill 2014, e enjte: *Nga vjen egjra në arën time - Misteri i të keqes: ku po shkoj?*
 - Ligjëruesi: Imzot Angelo Massafra

LE TË MBROJMË JETËN

Me datën 16 mars, e diela e II e krezhmeve, në katedralen e Shkodrës, gjatë Meshës së orës 10.00, kemi patur nderin të pranojmë një dëshmitar i famshëm për jetën: Mons. Philip Reilly, themeluesi i levizjes për jetën, i cili që 47 vjet në Amerikë dhe në shumë kombe predikon vlerën e jetës kundër abortit. Mons.

Philip ka qëndruar një javë në Shqipëri dhe ka patur takime në dioqezat e tjera me meshtarë, Motrat dhe besimtarë. Mons. Philip erdhi në Shkodër i përcjellur nga Dr. Majlinda Gjoni, Drejtoreshë e Karitasit –Tiranë, të cilën e falënderojmë.

KONFERENCË: “PLEQËRI NË SHTËPI”

Me datën 12 Mars Komuniteti Shën Egidio Shkodër dhe Drejtoria e Sherbimit Social Shkodër organizuan një Konferencë për të moshuarit në Shqipëri me temën: “Pleqëri në shtëpi” (Deinstitucionalizimi i moshës së tretë, si një politikë që mbështetet integrimin njerëzor dhe krijon një shoqëri për të gjithë brezat), ku u trajtuan problemet e të moshuarve si edhe nevoja që ata kanë të qëndrojnë pranë familjeve te tyre edhe të mos braktisen. Ne si komunitet kemi trajtuar temën për të moshuarit në aspektin e lidhjes që në kemi me ta për sensibilizimin e shoqërisë.

Konferenca u zhvillua tek Hotel Colosseo nga ora 10.00 deri me 12.30. Morën fjalën: Znj. Valbona Tula, Drejtore e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, Z. Maurizio Polselli, Konsuli Italian, Dr. Andrea Giovannelli, Përgjegjës i Komunitetit Sant Egidio për Rajonin, Dr. Paolo Tachella, Koordinator i fondeve e Rajonit Liguria, Dr. Merita Xhafaj, Drejtore e Përgjithsme e Politikave sociale, Znj. Ermira Pirdeni Drejtore e ASAG, Prof. Dr. Gëzim Dibra, Dekan i Fakultetit të Shkencave të Edukimit ULG, Dt. Stefano Pasta, i Komunitetit Sant’Egidio-Milano,MSF. Xhoana Marashi, Përgjegjëse e Komunitetit Sant’Egidio në Shqipëri, Mira Rrases, vullnetare fizioterapiste qe jep kontribut prane shtëpisë së moshuarve dhe një i moshuar i Shtëpisë së Moshuarve në Shkodër. Mori pjesë edhe Imzot Angelo Massafra OFM, Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pult dhe President i Konferencës Ipeshkvnore të Shqipërisë, i cili mbajti fjalimin si vijon:

Dëshiroj të filloj më fjalët e Biblës, prej Librit të Siracidit:

Kap. 3

Detyrat ndaj prindër

5. *Kush e nderon babën e vet, në fëmijë do të gjejë gëzim, dhe kur të lutet, urata do t'i dëgjohet.*
8. *Me vepra e me fjalë nderojë babën tënd, që të zbresë mbi ty bekimi i tij.*
12. *Biro, kije kujdes babën e plakur dhe mos e shqetëso gjatë jetës së tij.*
13. *Po edhe nëse dobësohet nga mendja, ji i butë me të, dhe mos e përbuz asnjëherë në jetën e tij.*
14. *Sepse ndihma e dhënë babës kurrë nuk do të harrohet, sepse do të mblidhet për shlyerje të mëkateve.*
15. *Ditën e vështirësisë sate Zotit do t'i bjerë ndër mend për ty, e, si dielli e shkrin akullin, mëkatet e tua do të shkrihen.*
16. *Se ç'zë të keq i sjell vetes, ai që braktis babën, i mallkuar prej Hyjit është ai, që e fyen t'ëmën.*

Kap. 7

- 28-29. *Me gjithë shpirt duaje babën tënd dhe mos i harro ofshamet e nënës sate.*
30. *Mos harro se s'do të kishe qenë pa ta: e çka do t'u japësh siç të dhanë ata?*

Në urdherimet e Zotit kemi te katertën që thotë: “Ndero Babën dhe nënën”.

Të nderuar, në lashtësi të moshuarit konsideroheshin si burime të jashtëzakonshme urtie. Çmoheshin, vlerësoheshin, respektoheshin. Ishin një pjesë aktive dhe e rëndësishme e shoqërisë... Dhe janë ende të tillë në shumë zona të Shqipërisë dhe në shumicën e familjeve tona nderohen, respektohen dhe janë të shërbyer.

Sot rrezikojmë të humbasim këtë vlerë të shoqërisë sonë; sa herë sot nuk i japim më aq shumë rëndësi pranisë dhe mësimi të tyre?

Të plakesh do të thotë të mos kesh më forcë si më përpara, mendja nuk punon më si një herë e një kohë dhe pra kështu pak nga pak të moshuarit izoloohen, mënjanoohen, zhvendosen sa këtu sa atje, tamam si sende.

Të moshuarit që jetojnë në një situatë vetmie apo që kanë vështirësi marrëdhëniore jo gjithmonë kanë nevojë për përkujdesje profesionale për të zgjidhur problemet e veta. Shpesh kanë nevojë për ndërhyrje apo mbështetje që përmirësojnë nevojat e tyre parësore të përditshme: ndihmë shtëpiake, kohë të lirë dhe shoqërizim. Këto nevoja që kanë

lidhje me jetën e përditshme, nëse plotësohen mund të parandalojnë vetminë, vështirësitë marrëdhënore dhe mungesën gjithnjë e më të madhe të vetëmjaftueshmërisë dhe të autonomisë.

Zgjedhja e azilit për personat e moshuar shpesh është një zgjedhje e detyruar nga ana e familjes. Edhe familja shqiptare nuk është më ajo e mëparshmja. Shpesh për arsye pune, është e detyruar të shkojë jashtë shteti dhe të emigroijë.



Nëse prindërit e moshuar janë të vetëmjaftueshëm qëndrojnë në shtëpinë e tyre, përndryshe, shpesh, u besohen Azileve.

Është e nevojshme që të rifitojmë vlerat e familjes, dhe për shqiptarët, familja, të paktën deri pak kohë më përpara, ishte një vlerë shumë e madhe. Duhet të kemi për zemër sidomos përkujdesjen ndaj prindërve tanë të moshuar, që kanë bërë sa e sa sakrifica për ne,atëherë, edhe ne është e drejtë dhe e kemi për detyrë që të bëjmë gjithçka është e mundur, që të qëndrojnë në gjirin e familjes së tyre, ku ka të rritur, të rinj, fëmijë, dhe ku duhet të ketë edhe gjyshër. Si thotë fjala e urtë popullore: ”e mjera ajo shtëpi pa pleq dhe pa fëmijë”.

Në këto 16 vite si Arqipeshkëv në Shkodër, kam bërë dy Vizita Kanonike Baritore Zyrtare: në vitet 2001-2002 dhe ne vitet 2006-2008, duke vizituar çdo fshat në fushë dhe në malet. Kam vënë re se, për shkak të emigracionit, në shumë fshatra banojnë vetëm pleqtë; shumë shtëpi janë bosh dhe hapën dritaret në verë kur familjalet vijnë për pushime. Në çdo fshat kam bërë këtë thirrje, dhe e përsëris sot, që një prej fëmijve të qëndrojnë, për detyrë morale dhe mirënjohje, të jetojnë në Shqipëri me prindërit dhe vëllezërit e tjerë, që janë jashtë, t'i indihmojnë ekonomikisht nëse kanë nevojë.

Sa familje vijnë tek unë, te kuvendet e Motrave, te famullitë, për të kërkuar ndihmë për shtrehim, për ilaçe, dhe kërkojnë paret për të bërë një skaner, një risonancë magnetike ose për një ndërhyrje kirurgjikale! Ku është Shteti? Ku janë strukturat shtetërore? Si funksionojnë?

Personat e moshuar kanë të drejtë të qëndrojnë përgjithmonë në shtëpinë e tyre, sepse, edhe kur humbasin aftësitë e tyre funksionale, kanë akoma shumë për të dhënë, sidomos nipave dhe mbesave. Në këtë mënyrë ata nuk ndihen si një barrë, të padobishëm, por ndihen të dashur, të çmuar dhe të vlerësuar. Të bëjmë të mundur që të moshuarit të mos vuajnë prej vetmisë, braktisjes, mungesës së dashurisë dhe përkujdesjes, por t'u japim atyre kohën dhe vëmendjen që meritojnë. Dhe në këmbim do të marrim një jetë më të qetë dhe bekimin e Zotit.

Po e mbyll me dy mendime: të parin na e ofron shkrimtarja dhe filozofja e madhe Simone de Beauvoir: “Nëse për 15-20 vitet e fundit të jetës së tij një njeri nuk është tjetër veçse një fundërrinë (scarto di uomo), një gjë e tillë do të dëshmonte dështimin e civilizimit tonë...”, kurse të dytin Papa Françesku: “Çdo i moshuar, edhe pse i sëmurë apo në ditët e tij të fundit, mbart në vetvete fytyrën e Krishtit dhe për këtë arsye nuk ka jetë për të skartuar”. Te nderuar, pleqëria është një sfidë për të gjithë.

Xhoana Marashi

ZOJA SHTEGTARE E FATIMAS NË SHKODËR



*Kujtime nga vizita e trupores së Zojës Fatima në Shkodër
(18 janar – 7 shkurt 2014)*

Me këtë shkrim dëshiroj që të bashkëndaj disa kujtime mbi sa kam përjetuar tre javët që në Kishën Katedrale të Shkodrës ka qëndruar truporja shtegtare e Zojës Fatima. Pata fatin që ndërsa ende jam me shërbim në Katedrale të Shkodrës ta përjetoja nga afër këtë vizitë dhe ta prekja personalisht truporen e Zojës përpara se të shfaqej publikisht për të gjithë të devotshmit e saj. Atë, truporen që sapo kishte ardhur dhe unë isha ndër të parët që e pashë, më është dukur sikur më bëhej një dhuratë e madhe ... sikur isha i thirrur të bëhesha dëshmitar e shoqërues i një përfytyrimi nëpër të cilin dikur Qielli kishte dashur të komunikonte me botën. U emocionova dhe menjëherë ndërsa e prekja i drejtova lutjet e para në gjuhën



shqipe. I kërkova ndera shpirtërore e ndërmjetësim.

Me Paulinin, Ndojën dhe Xhuljon përgatitëm makinën e etërve orioninë e gjithçka që duhej për transportin e trupores. Mbrëmjen e së



ZOJA SHTEGTARE E FATIMAS NË SHKODËR

Vijim i fq. 5



premtës dt. 17 janar makinën e zbukuruan me shumë kujdes Angelina, Greta dhe Doriani. Gjithçka ishte gati.

E kam të paharrueshme ditën e shtunë, datë 18 janar 2014, kur heret në mëngjes i shoqëruar nga fra Vincenzo ofm dhe nga ministrantët Florenci dhe Gjoni ... udhëtoja drejt Shkodrës me



truporen e Zojës Fatima ... përpara nesh në një tjetër makinë ishte Arqipeshkvi dhe ... më përpara akoma, atje poshtë kalasë Rozafa një turmë e madhe populli e shoqëruar nga meshtarë e motra i këndonin Zojës e luteshin duke pritur ... më dukej se dëgjoheshin fort lutjet e tyre në makinën tonë ... sepse aty ishte ajo ... truporja.



Eh sa bukur, kur kemi arritur te Kisha e Zojës së Këshillit të Mirë. Më dukej krenare Zoja e Kishës së Kalasë që i jepte mirëseardhjen Zojës Fatima duke i thënë “a m'i sheh bijtë e mi ... janë të devotshëm ... nuk më braktisin”. Pas lutjeve u nisëm drejt Katedrales. Motrat me në krye motër Violetën, Paulinin, motër Cristianën dhe motër Carmen, Atë Aurelin ofm etj., kishin organizuar fëmijët e katekizmit të famullisë që ta pritnin truporen si mos më mirë. Valentini i kishte ndezur kumonët e hapur dyert e Katedrales, ministrantët pritnin të veshur me petkat e bardha, fëmijët e katekizmit dhe besimtarë të shumtë që kishin dalë e pritnin me padurim të përsëritshëm me lule e brohoritje truporen e Zojës. Edhe Sarreqi ishte fantastik atë ditë ... Policia e Shtetit dhe ajo Bashkiake kishin bllokuar gjithçka që njerëzit të mund ta shijonin me paqe ardhjen e trupores së Zojës Fatima.



Prej këtij çasti truporja qëndroi në kishën Katedrale dhe për asnjë çast nuk qe vetëm. Mijëra e mijëra do ta rrethonin e preknin. Do të qanin në lutje para saj dhe do të ngushëlloheshin, ndërsa i porositin veten, të afërmit dhe qëllimet e zemrës ndërmjetësimi të Zojës Fatima. Por shumë afër i qëndruan në çdo çast Jolanda, Donaldi, Nikolla, Nikoja, Juani dhe Armandoja ... ishin engjt e rojës të Zojës ato ditë. Zoja qëndroi e rrethuar nga lulet e dhuruara pandërprerje nga besimtarët dhe e stolisur nga motër Violeta, solemnisht e vendosur falë punës së Ndojës dhe Ganisë si dhe të të gjithë bashkëpunëtorëve të tyre. Qëndroi e shoqëruar gjithë kohën me rruzaren e medituar e të udhehequr nga ministrantat e palodhshëm e të çmuar si dhe nga muzika dhe këngët e Lukës dhe të koreve të Katedrales. Sa bukur qëndronte aty ku Arqipeshkvi e kishte dashur, pasi ai donte që ta preknin të gjithë.



Vijon në fq. 7

ZOJA SHTEGTARE E FATIMAS NË SHKODËR

Vijim i fq. 6

Lutja e mbrëmësore me të gjitha motrat e kuvendeve rregulltare që janë në qytet; adhurimi gjithë natën kur erdhi si edhe natën para se të shkonte me lutjen e rruzares nga kuvendet e motrave dhe grupet rinore, e organizime kishtarë e familjesh besimtare si dhe meshtarët; lutja Ekumenike; vizitat e kopshteve, shkollave fillore dhe të mesme; rruzarja me gratë e familjeve në gjak; shtegtimet e Zonave Baritore, të Legjionit të Marisë, të famullive të ndryshme si dhe fëmijëve të katekizmit për



Kungimin e parë e Krezmim; Tre-ditëshe me adhurim e predikim dhe rrëfime nga meshtarët e shumtë; procesioni me truporen e Zojës nëpër disa rrugë të qytetit të Shkodrës organizuar nga Këshilli Baritor i Famullisë si dhe grupet rinore të qytetit, të Velipojës e Seminari Ndërdioqezan Shqiptar; mesha e shugurimit të familjeve; Dita e të Kushtuarve; Dita e të Sëmurëve dhe procesioni me ta dhe me truporen, ishin zinxhiri i pashkëputur i afektit shpirtëror që na mahniti të gjithëve. Truporen e Zojës Fatima nuk e vizituan vetëm katolikë, por edhe vëllezër e motra të feve të tjera e madje edhe jobesimtarë.

Dhurata pafund u lanë tek këmbët e trupores, të cilat do t'i dorëzohen shenjtërores së Zojës në Fatima si një dëshmi e gjallë e dashurisë dhe e devocionit për Zojën.

Por dua të veçoj në këto kujtime tre-ditëshen e kushtuar Zojës në datat 27-29 janar: ishte një mrekulli kur ndërsa dom Preka predikonte dhe udhëhiqte adhurimin, meshtarët e dioqezës



(që i falenderoj pamasë) në çdo cep të Katedrales rrëfenin për tre ditë rradhazi ... ishte mrekulli.

Me shumë emocion ishte edhe dita e fundit e qëndrimit të trupores në Shkodër, të premten e datës 7 shkurt. Katedralja filloi të mbushej qysh herët nga besimtarë që vinin nga lagjet e qytetit e nga të gjitha fshatrat e fushës e të malësisë. U mbush plot ... po plot. Pa propagandë televizive. Pa postera elektorale. Pa servila ... por me besimtarë. Me njerëz fisnikë që besojnë se Qielli dhe Toka mund të takohen dhe mund të jetojnë amshimin së bashku. I thirri Shpirti i Zotit ... është Ai që na tërheq në bukurinë e shpirtit. Plot lutje e lot u kremtu mesha e shenjtë nga Arqipeshkvi ynë, i cili me këtë nisëm diti të bashkojë dioqezën e tij. Plot meshtarë e besimtarë, rregulltarë e rregulltare që krah për krah iu përgjigjën erës së Shpirtit për të dëshmuar se për të



krishterët në Veri të Shqipërisë feja është e shtrenjtë dhe e shenjtë ... se Zoti dhe Zoja janë pasuri që bashkojnë të majtë e të djathtë, qytetarë e fshatarë, të pasur e të varfërfukara, miq e armiq. Po, qe profetike prania e Zojës, sepse kështu do të bashkohemi në qiell një ditë ... të gjithë.

Tashti, mbi komodinë tek kryet e shtratit kam vendosur një trupore të vogël të Zojës Fatima dhe sa herë që shoh shkrihem dhe ndiej mall për lodhjen e atyre orëve, ditëve, javëve. Për fytyrat e besimtarëve që rrezatonin mirësi ndërsa i afroreshin trupores së Zojës.

Zotit i qoftë lăvdia dhe nderi, sepse për më të madhen lavdi të tij e për dobinë e njeriut u bë e bëhet gjithçka.

Dom Gjovalin Sukaj

Vijon në fq. 8

ZOJA SHTEGTARE E FATIMAS NË SHKODËR

DËSHMI E DOM CHARBEL BACHOUR

Vijim i fq. 7



Ky vit është mjaft i veçantë. Arqipeshkvi ynë i dashur, Shkelqesia e Tij Imzot Angelo Massafra na e ka dhënë hirin duke marrë iniciativën për të sjellë Truporen e Zojës Fatima në Shkodër.

Kemi pasur dy javë me të vërtetë intensive Adhurimi, lutjeje, Meshe dhe Shtegtimesh të bëra nga Famullia jonë e Shën Mikelit në Rragam dhe Shën Jeronimit në Sheldi, bashkë me famullitarin tonë Dom Charbel dhe motrat tona të palodhshme Salvatoriane dhe patëm



për t'i treguar që e dimë se jemi mëkatarë, por jemi ende bijtë e saj dhe kemi nevojë për kujdesin dhe mbrojtjen e saj amnore. Patëm privilegjin që të kalonim pak kohë në Adhurimin e natës e organizuar në Katedrale, ku Truporja e Zojës ka qëndruar gjatë gjithë kohës, duke mirëpritur shtegtarë nga krejt Dioqeza dhe vende të tjera.

Edhe ne të zonës numër 4 patëm një ditë, kur u organizuam në një mënyrë të mrekullueshme për të shkuar tek Zoja në këmbë nga Rragami deri në Katedrale. Ishte me të vërtetë një përvojë emocionuese e



disa mundësi për ta jetuar mesazhin dhe përsëritërinë e këtyre javëve.

Ishim aty të pranishëm kur arriti Truporja tek Shenjtërorja e Zojës së Shkodrës për ta mirëpritur dhe për t'ia paraqitur të gjitha shqetësimet dhe lutjet tona e mbi të gjitha për t'i treguar se ne e duam,



Rrëshajëve, bashkë me Dom Charbel dhe Motrat tona.

E falënderojmë Hyjin për këtë mundësi. Falënderojmë Arqipeshkvin tonë, famullitarin dhe motrat tona dhe të gjithë ata që punuan pa u lodhur për të arritur suksesin e kësaj ngjarjeje kaq të madhe. Lutemi për të gjithë!

DELEGATËT EUROPIANË PËR BARITORËN UNIVERSITARE NË TIRANË

Rreth 30 pjesëmarrës, përgjegjës kombëtarë për baritorën universitare të Konferencave Ipeshkvore të Evropës dhe të lëvizjeve kishtarë europiane kanë zhvilluar një takim në Tiranë (Shqipëri) duke filluar nga data 23 mars në mbrëmje deri më 26 mars paradite. Tema e konferencës “Gëzimi i jetës si dhuratë që të jepet apo si thesar që duhet kërkuar” (Gj. 10,10; 15,11). Punimet filluan me përshëndetjen e Imzot Marek Jędraszewski, President i Seksionit Universitar të Komisionit

“Katekizëm, Shkollë dhe Universitet” të KKIE si dhe të don Michel Remery, Zv –Sekretar i Pëgjithshëm i KKIE.

Ditët e takimit kanë patur momente lutjeje dhe kremtimesh eukaristike: më 24 kryesoi Meshën Imzot Angelo Massafra, Arqipeshkëv i Shkodër-Pult dhe Presidenti i Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë.

SHËRBIMI NDAJ VËLLEZËRVE TANË ROMË



Prej disa vitesh Motrat Kapuçine të Zojës së Papërlyer të Lurdit janë kujdesur për nevojat e më të varfërve të qytetit të Shkodrës që jetojnë në periferi dhe që pavarësisht se përshkojnë përditë rrugët e qytetit, duket se janë të

padukshëm për pjesën më të madhe të njerëzve. Shërbimi përbëhet në afrimin me zemër të këtyre vëllezërve të ndryshëm për nga kultura e mënyra e të jetuarit dhe kuptimi i nevojave të tyre, i jetës së tyre të vështirë, i varfërisë së tyre të madhe dhe patjetër edhe i dinjitetit të tyre të madh në përballimin e nevojave të mbijetesës.

Nga kontakti njerëzor, gati i përditshëm, lind fillimisht nevoja për t'u dhënë atyre nocionet bazë që të mund të mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë me kurse alfabetizimi, por më tej është ndier nevoja që të hiqen prej rrugës të miturit që për moshën e tyre kanë të drejta të tjera dhe kështu nga shtatori i vitit 2013 pranë fshatit të paqes është hapur një qendër për të miturit romë me nxitjen e Shkëlqesisë së Tij Imzot Angelo Massafra dhe angazhimin e motrave kapuçine.

Në qendër, të miturit ndiqen me vëmendje dhe dashuri nga edukatorë të zotët që nëpërmjet një programi gati të personalizuar për nevojat e tyre, i ndihmojnë në zhvillimin dhe në përmirësimin e personit të tyre njerëzor dhe në integrimin me vetë shoqërinë.

Një falënderim i përzemërt i shkon Caritas-it dhe personave të tjerë vullnetmirë që na ndihmojnë të realizojmë shërbimin njerëzor e bamirës në dobi të të miturve romë.

Mt. Riccarda dhe Mt. Franca

DITA E TË SËMURËVE NË SHKODËR



Me dt 06.02.2014, në Katedralen e Shën Shtjefnit , u kremtua Mesha e Shenjtë nga Shkelqësia e tij, Imzot Angelo Massafra për të sëmurët. Në meshë morën pjesë mijëra besimtarë nga e gjithë Dioqeza. Të pranishëm kanë qënë shumë të sëmurë, të rinjtë e të rejtat me aftësi të kufizuar të Projektit Shpresa, Instituti i Motrave të Nënë Terezës, Madonnina del Grappa, Qendra e Zhvillimit Shtetëror e të tjerë të shoqëruar me edukatorët ose kujdestarët e tyre. Të sëmuret e tjerë u sollën në Katedrale fale angazhimit të Motrave Vinçenciane të Motrave të Nenë Terezës, Malteser dhe Caritasit Dioqezan.

Imzot Massafra e filloi Meshën e Shenjtë duke vënë në dukje se këtë vit ndryshe nga vitet e tjerat, Dita e të Sëmurëve dhe Punonjësve të Shëndetsisë përkujtohet jo me 11 shkurt por sot me 6 shkurt me rastin e pranisë së Zojës Fatima në Shkodër.

Gjatë Meshës tre të rinjtë të Projektit Shpresa, të ndihmuar nga

Motër Enza Ferrara, dhuruan një Ikonë të Zojës, bukën dhe verën.

Gjatë procesionit me të Shenjtërueshmin Sakrament, Dom Gjovalini bëri thirrje që të mbahen qirinjtë e ndezur.

Arqipeshkvi e përfundoi Meshën e Shenjtë duke u lutur për të gjithë të sëmurët e pranishëm dhe sidomos për ata të cilët për arsytet ndyshme nuk kanë mundur të jenë të pranishëm në Meshë. Gjithashtu ai falenderoi të gjithë personat që kujdesen për njerëzit e sëmurë, që sikur ka thënë Nënë Tereza bëjnë “përkushtim ndaj të varfërve më të varfër” dhe theksoi thirrjen që ka bërë edhe Papa Françesku duke u lutur që Zoti të na japë hirin të kuptojmë mesazhet e Zojës Fatima dhe ti zbatojmë ato që njerëzit të jenë më të mirë, e bota të jetë e dashur dhe me besim të plotë.

Pas Meshës, të gjithë besimtarët u ftuan që të marrin pjesë në programin kushtuar kësaj Dite që u zhvillua tek Salla Kardinal Mikel Koliqi. Protagoniste e këtij programi ishin vete të rinjtë e femijët e institucioneve të mësipërme.

Jolanda Marena



50-VJETORI I THEMELIMIT TË MOTRAVE OBLATE TË ZEMRËS SË PAPËRLYER TË MARISË

Bashkësia e Motrave Oblate është themeluar më 24 nëntor të vitit 1963 nga Motër Lodovica Pellegrini që ende jeton, bashkë me dy motra të tjera të cilat po në këtë datë kanë filluar noviciatin e tyre në Rado të Gatinarës në dioqezën e Verçelit.

Motër Lodovica Pellegrini e ndien veten të thirrur për ta jetuar më thellësisht mesazhin e Zojës Ruzare në Fatima për lutje dhe pendesë për kthimin e mëkatarëve dhe prandaj, e frymëzuar nga kjo thirrje, e braktisi karmelin për të filluar një jetë të re kushtuar pikërisht mesazhit të Fatimas nga i cili mori burim edhe përshpirtëria e Kongregatës sonë. Të frymëzuara nga kjo përshpirtëri, bashkësitë tona angazhohen për përhapjen e këtij mesazhi nëpërmjet shtegtimeve të ndryshme me truporen e Zojës së Fatimas që i kemi realizuar dhe ende vazhdojnë të zhvillohen nëpër dioqeza të ndryshme, sidomos në Itali.

Kjo familje rregulltare ua hapi dyert edhe thirrjeve të reja nga vende të ndryshme të botës. Mbas një përvoje shpirtërore dhe formimi të posaçëm, motrat hapin bashkësi të reja në dioqeza të ndryshme të Italisë dhe në disa vende të ndryshme të botës, Filipine, Indi, Rumani dhe Shqipëri.

Kudo që motrat tona ndodhen zhvillojnë aktivitete nga më të ndryshmet, japin kontributin e tyre në famullinë ku gjenden, kanë hapur kopshte për fëmijë, shkolla dhe konvikte, etj. Gjithashtu punojnë për prodhimin e hosteve, u bëjnë vizita të burgosurve dhe duke parë

nevojat në disa vende, kanë hapur azile për të moshuarit ku vetë motrat kujdesen për ta.

Më 8/11/1992 motrat tona, për herë të parë shkelën tokën shqiptare të

martirizuar nga diktatura e ashpër komuniste. Fillimisht u takuan me një varfëri totale, por mbetën të mahnitura nga feja e gjallë që populli shqiptar ka arritur ta ruajë të paprekshme në familjet dhe në zemrat e tyre.

Me shumë varfëri dhe vështirësi motrat e filluan misionin e tyre duke iu përshtatur traditave shqiptare. Së pari punuan në mirëmbajtjen e seminarit dhe ndërkohë shkonin nëpër fshatrat malore për të bërë katekizëm, deri sa u vendosën në fshatin Barbullush më 01/01/1995. Kur shkuan në këtë fshat gjetën vetëm ndërtesën e kishës të shndërruar gjatë periudhës komuniste në oficinë. Gjatë këtyre viteve

ndërtuan kishën e re, shtëpinë dhe mjediset për veprimtari të tjera.

Çdo punë dhe çdo veprimtari që motrat zhvillojnë e ka burimin në një takim të përditshëm me Zotin (në lutje, adhurim dhe meshë), i cili i ka zgjedhur e thirrur që të jenë dëshmi e gjallë e pranisë dhe e dashurisë së Tij pranë vëllezërve e motrave.

Një falënderim të perzemert dhe të panderprerë ia lartësojnë Zotit për të gjitha huret dhe bamirësitë e Tij që nuk kanë munguar në jetën e tyre dhe në çdo vend ku ndodhen.

Vera Preku

KONKURS PËR MONUMENTIN NË KUJTIM TË VIKTIMAVE TË KOMUNIZMIT

Kisha Katolike në Shqipëri, tradicionalisht nuk është marrë vetëm me punë baritore, por ka kontribuar në të gjitha sferat që ndikojnë në mirëqënien dhe zhvillimin e shoqërisë.

Meritat e Kishës në fushat e edukimit, arsimimit, artit dhe kulturës janë të pamohueshme. Si dëshmi të këtyre sa thamë, mund të përmendim shkollat katolike, të cilësuar nga të gjithë si më të mirat në vend të të gjitha kohërave, dhe një numër të madh veprash letrare dhe publicistike pa të cilat shqipja e shkruar do të ishte shumë më e varfër.

Rrethanat e trazuara historike të gjysmës së dytë shek XX kanë sjellë për Kishën Katolike edhe një përfshirje, jo të zakonit për institucionet e kultit, në politikë. Nuk është fjala këtu për përfshirje të mirëfilltë, çka do të nënkuptonte propagandimin në favor të një force politike të caktuar, po për mbrojtje të vlerave dhe

parimeve në të cilat besonin. Konkretisht, gjatë periudhës së regjimit komunist (1945 – 1990) shteti i kohës ndërmori një sulm të pashembullt kundër klerit, veçanërisht atij katolik. Kjo furi shkatërrimtare kulmoi me fushatën famëkeqe të 1967-ës ku kishat u dogjën, u shkatërruan dhe

u përdhosën duke u dhënë funksione pragmatike si kinema apo pallate sporti; të gjitha praktikat fetare u ndaluan me ligj dhe Shqipëria u vetëshpall i pari dhe i vetmi vend ateist në botë. Klerikët katolikë, si pjesa më intelektuale dhe fisnike e kombit, sigurisht që nuk mund të pajtoheshin me ideologjinë e imponuar nga shteti dhe për këtë arsye u përndoqën pa mëshirë. Dyzet është numri i martirëve të kishës që u ekzekutuan me vdekje në periudhën 1945-67. Numri i atyre që e ngrysen jetën në burgjet e tmerrshme dhe në kampet e punës së detyruar si: Burrel, Spaç, Qafë e Barit etj. është edhe më i madh. Pikërisht në nderim të veprës dhe

sakrificës së këtyre martirëve dhe të të gjithë atyre që për hir të idealeve të tyre u viktimizuan nga regjimi i kaluar, Komisioni Drejtësi dhe Paqe i

Vijon në fq. 11



LAJME NGA DIOQEZA E SAPËS

SHTEGTIMI I ZOJËS FATIMA NE SAPË



Me vendim të Konferencës Ipeshkvore të Shqipërisë, truporja shtegtare e Zojës Fatima po shtegton dioqezë më dioqezë, duke bërë që kjo nënë qiellore të ndërmjetësojë tek Hyji, Zoti ynë, për mbarë popullin shqiptar. Ndaj, kjo kohë Shenjte, e cila thërret njeriun në kthim dhe pajtim me Zotin dhe njeriun, për Dioqezën e Sapës përkon me ardhjen e truporës së Zojës Fatima nga Portugalia, e cila, që prej datës 3-20 mars po viziton famullitë tona. Në lidhje me këtë shtegtim ipeshkvi i Sapës, imzot Lucjan Avgustini, duke pasur parasysh



dëftimin e Zojës në Fatima, thirrjen e saj drejtuar njerëzimit, si dhe duke e njohur situatën e besimtarëve, posaçë në ato famulli ku jetohej e keqja e mëkatit kundër jetës, duke theksuar këtu vrasjen dhe dëshirën për hakmarrje apo për të marrë gjak, së bashku me klerin dhe bashkëpunëtorët e tij kanë dashur që në këtë periudhë të qëndrimit të Zojës Fatima, duke e thirrur ndërmjetësinë dhe ndihmën e saj

qiellore, të gjithë besimtarët nëpërmjet lutjeve dhe meshëve të sensibilizohen për largimin e kësaj të keqeje. Për këtë arsye, gjatë kësaj periudhe që përkon dhe me kohën e kreshmeve, kanë filluar lutjet, rrëfimet, adhurimi, kremtimi eukaristik, shtegtimi i truporës së Zojës Fatima në të gjitha famullitë e Dioqezës. Vetë Shkëlqesia e Tij, Ipeshkvi i Dioqezës së Sapës ka bërë thirrje që të pajtohemi me Zotin dhe njëri-tjetrin. Pikërisht për këtë arsye, ai kërkon posaçërisht angazhimin e të gjithë besimtarëve. Me qëllim sensibilizimi dhe ndërgjegjësimi për një punë të tillë, Imzot Lucjan Avgustini ka ftuar meshtarit nga Kosova, Vikarin e përgjithshëm, Don Lush Gjergjin, i cili ka pasur një përvojë të begatshme në pajtimin e familjeve që kanë jetuar në gjak së bashku me pajtimtarin Prof. Anton Qetën e të tjerë.

Shtegtimi i Zojës Fatima në Sapë ka filluar me kryeqendrën e kësaj dioqeze, në famullinë e Shën Kollit në Vau-Dejës, ku me dëshirë dhe lutje familjet i janë drejtuar Zojës, nënës së Hyjit dhe nënës sonë, duke i kërkuar



që të ndërmjetësojë para Zotit që të ketë bekimi, paqe dhe lumturi në familjet tona; që hiri dhe bekimi i Zotit të shoqërojë çdo besimtar, çdo familje edhe në mbarë famullinë, shoqërinë dhe komunitetin. Pas qëndrimit në këtë famulli, truporja e Zojës Fatima po kalon nëpër famullitë e tjera e shoqëruar nga famullitarët përkatës, ndërkohë që i deleguari për këtë rast, don Lush Gjergji ndërsa shoqëron kremtimet e rastit, gjatë fjalës së tij është ndalur në rëndësinë e Zojës Fatima, duke shpjeguar të gjitha shfaqjet e saj në Fatima, ku Nëna e Lume nënvizoi vazhdimisht nevojën për të lutur çdo ditë Rruzaren, për të kryer vepra kthimi dhe sakrifice. Ndërmjetësia e Zojës Fatima na ndihmoftë në largimin e mëkatit të vrasjes dhe në angazhimin tonë për paqe dhe Jetë me Zotin dhe njëri tjetrin.

Violeta Marashi

KONKURS PËR MONUMENTIN
NË KUJTIM TË VIKTIMAVE TË KOMUNIZMIT

Vijim i fq. 10

Shqipërisë, me president Imzot Angelo Massafra – Arqipeshkëv Metropolit i Dioqezit Shkodër-Pult, në bashkëpunim me fondacionet gjermane Renovabis dhe Maximilian Kolbe, ka ndërmarrë një projekt i çili ka për qëllim ripërtëritjen e kujtesës historike kombëtare. Edhe pse nuk është në dorën tonë ta ndryshojmë të kaluarën, të paktën mund të bëjmë diçka për të mos e harruar në mënyre që gabimet e saj të mos përsëriten.

Në kuadër të këtij projekti, KDP ka organizuar një konkurs ku morën pjesë 15 skulptorë të qytetit të Shkodrës për ndërtimin e një monumenti në kujtim të viktimave të komunizmit që do të vendoset përballë godinës

së bashkisë, pak metra larg vendit ku ndodhej dikur burgu i Shkodrës.

Më 23 janar 2014 në mjediset e Galerisë së Arteve u hap një ekspozitë me të gjitha bocetet pjesëmarrëse në konkurs. Binte në sy krahas cilësisë së lartë artistike të veprave të paraqitura, edhe prania e personaliteteve më të njohura të artit, kulturës dhe pushtetit vendor.

Në votimin që u bë me këtë rast, fituese u shpall vepra e skulptorit Petrit Kruja. Nuk është e largët dita kur monumentin do ta shihni të vendosur në parkun e shëtitores së qytetit, por ndërkaq mund t'i hidhni një sy bocetit në faqen: www.juspaxalbania.org.

Vladimir Banushi

UDHA E KRYQIT NË TARABOSH



16 vjet më parë, në vitin 1998, kur Shqipëria po kalonte kohë të trazuara, një grup të rinjsh të katedrales së Shkodrës deshën që Udhën e Kryqit ta bashkëndanin me të rinj të tjerë të dioqezës, në malin Tarabosh. Që atëherë, çdo vit në kohën e kreshmëve, një e shtunë caktohet pikërisht për këtë përjetim shpirtëror. Dhe pjesëmarrësit janë përherë të shumtë në numër, kryesisht të rinj por edhe të moshave të tjera, të ardhur nga shumë famulli.

Këtë vit, më 15 mars, për të 17-n herë Taraboshi qe “Kalvari” ku besimtarë të shumtë, në lutje e meditim, shoqëruan Jezu Krishtin në atë udhë të mundimeve, në atë udhë të kryqit, pa të cilën bota nuk do ta kishte njohur shëlbimin e sjellë nga Ai. Në krye të besimtarëve të vet qe arqipeshkvi i Shkodër-Pultit, Imzot Angelo Massafra.



Gjatë 14 ndalesave mbajtën kryqin dhe lexuan meditimet 14 grupe të ndryshme të rinjsh. Pranë kryqit, bashkë me të rinjtë, ishte Dom Gjovalin

Sukaj, që 16 vjet më parë ishte njëri ndër të rinjtë iniciatorë dhe organizatorë të Udhës së Kryqit në Tarabosh, ndërsa sot është famullitar i katedrales.

Meditimet shumë prekëse, me temën “I varfri që më pasuron”, ishin marrë nga Papa Françesku, i cili nxiti çdo besimtar ta hapë zemrën e vet ndaj çdo varfërie, ndaj çdo të varfri. Në këtë linjë, edhe imzot Massafra, në mesazhin e vet në përfundim të Udhës së Kryqit, ftoi që secili, në gjurmët e Jezu Krishtit, t'i hapet dashurisë, dashurisë për Zotin dhe për të afërmin, duke falur dhe duke bërë veprat që i kanë hije të krishterit, duke respektuar jetën si dhuratë të Hyjit.

Angjelina Gjeka



PËRURORHET SHTËPIA FAMILJE “FOLEJA” (NIDO)



Edhe pse mes vështirësishë të panumërta, pas vdekjes së themelueses së tij, të së ndjerës Silvana Vignali, “Projekti Shpresa”, i cili i kujdeset për personat me aftësi të kufizuara, ka arritur të çojë përpara një eksperiencë të veçantë dhe të rrallë jo vetëm për Shkodrën dhe Shqipërinë, por edhe për Europën dhe më gjërë. Aplikimi i të ashtuquajturave “shtëpi familje” ka patur si qëllim vendosjen e personave me aftësi të kufizuara në ambiente të ngjashme ku çdo familje tjetër “normale” jeton. Duke synuar që të “korigjojë” një padrejtësi të madhe që këtyre fëmijëve dhe të rinjve u është bërë, duke i privuar, ndoshta përjetësisht nga ngrohtësia që të jep jetesa në gjirin familjar dhe komoditetet që mjediset e sajë të ofrojnë.

Aktulisht ky projekt ka shtatë “shtëpi familje”, të vendosura në tre qendra të mëdha. Njëra nga “shtëpitë familje” dhe pikërisht shtëpia “Foleja” (Nido) është transferuar tek shtëpia familje “Balona” (Aquilone) e cila është rindërtuar dhe u përshtat për nevojat e tre të rinjve që do të banojnë aty në menyra autonome sepse janë të aftë për të patur një jetë të pavarur. Përrurimi i shtëpisë familje “Foleja” u bë me dt. 10 Mars 2014 duke marrë bekimin e Imzot Angelo Massafra.

Po ashtu nga Zyra Rajonale e Shërbimeve Sociale të Qarkut Shkodër mori pjesë Z. Valbona Tula me stafin e saj. Tashmë kjo “Folezë” mban në gjirin e sajë të ngrohtë tre nga 60 banorët e Prejektivit Shpresa, të cilët një ditë do të “fluturojnë” për të vazhduar një jetë të re të pavarur.

Rrok Daka



Drejtues
Imzot Angelo Massafra

Redaksia
Arqipeshkvia

Lektore
Emanuela Marku Matjia

Faqosja
Luigj Milla

Shtypshkronja
“Gjergj Fishta”
Lezhë